

Ish-minatorët në protestë

Prej disa të enjtesh radhazi, një kolektiv ish-minatorësh kanë protestuar para Kuvendit të Shqipërisë për tu njohur me ligj vështirësia dhe vjetërsia e punës në minierë, si dhe si profesion puna e minatorit nën tokë. Ata janë tubuar në dyert e organit më të lartë që supozohet se bart vullnetin e popullit, Parlamentit, por pavarësisht zërit tyre të lartë, janë përballur me indiferencën e përfaqësuesve politikë dhe represion policor.

Ish-minatorët e grumbulluar në protestë theksuan se numri i tyre po zbogëlohet përditë pa e parë kurrë djersën e tyre të shpërbyler; se edhe një pavion të specializuar për sëmundjet profesionale që ekzistonte në spitalin publik e kanë mbyllur; se ata kanë mbajtur dy regjime në këmbë por mezi i mbulojnë dy vakte në ditë; se shumë njerëz të kësaj kategorie kanë lënë

gjymtyrët, sytë dhe jetën në këtë sektor pa iu njohur kurrë sakrifica. Se ata kërkojnë pensione më të larta për veten por edhe paga më të larta për ata minatorët që vazhdojnë të futen thellë në tokën e Shqipërisë përditë.

Është ironike sesi në Shqipëri statusin e zanatit profesional e gjëzojnë si ushtarakët, si deputetët, ashtu edhe punëtorët e shërbimit informativ, por jo edhe pjesa më e madhe, e stërmunduar dhe me vdekshmërinë më të lartë të ish-klasës punëtore. Përveç ish-minatorëve, minatorëve në gjendje pune anëkënd Shqipërisë, me kolektivin e tyre janë solidarizuar edhe aktivistë të Lëvizjes BASHKË! Këta burra dhe gra të ndershme duhen mbështetur nga të gjithë qytetarët që jetojnë me krahët e tyre. ■

Një vajzë e re sot në Bathore

nga Redi Muçi

Para pak ditësh pata rastin të vizitoj Bathoren e të takoj tri vajza adoleshente të cilat e kishin lënë gjimnazin dhe punonin në një fasoneri italiane që prodhon këpucë të markave më të mira. Biseda me to ishte si një udhëtim pas në kohë rreth dy shekuj – shfrytëzimi në punë, realiteti zakonor, sakrifica për hir të familjes... e megjithatë ato ngjanin si çdo moshatare e tyre nëpër gjimnazet e metropolit. Vetëm pak kilometra larg tij, por sa qindra vjet mbrapa? Reshtat e mëposhtëm janë një sintetizim i bisedës me to, ku faktet përshkuhen tamam ashtu siç u rrëfyen nga gojët e tyre.

Një vajzë e re sot në Bathore është e lirë të vazhdojë shkollën e mesme, është e lirë. Por ajo zgjedh të punojë në fabrikë sepse familja nuk mbahet dot vetëm me rrogën e nënës. Ndërtimet janë rralluar, hashashi nuk nga burri në burrë. Pronari i ri – burri – edhe po i dha mbillet më, kështu që babai është i papunë. Vëllai ka emigruar në Angli me kamionët e transportit të mall-

rave. Prandaj liria për shkollë asaj nuk i jep bukë, puna po.

Një vajzë e re sot në Bathore është e lirë të punojë tetë orë në ditë nga e hëna në të premte, është e lirë. Por është e lirë edhe ta humbasë vendin e punës nëse nuk punon jashtë orarit për shtatë ditë në javë, të paktën gjatë atyre javëve kur kamioni me këpucë niset për Itali, kur italia nët mund të ngelen këmbëzbathur nëse duart e saj nuk punojnë edhe të dielen.

Një vajzë e re sot në Bathore është e lirë të dashurojë, është e lirë. Por martesa dhe burri janë dy gjëra që s'varen prej saj. Dashuria është për shokun; martesa është për të siguruar nderin dhe të ardhmen e familjes. Burrin e zgjedh babai dhe shkëmbimi ndodh nga burri në burrë. Pronari i ri – burri – edhe po i dha një dru të mirë, është burrë.

Një vajzë e re sot në Bathore është e lirë të bëjë pushim gjysmë ore gjatë orarit të punës, sa për të ngrënë e për të kryer nevojat personale, është e lirë. Por ajo gjysmë ore do t'i shtohet në fund të ditës nëse ajo do që pagën minimale ta marrë të plotë për atë ditë pune. Për të ngrënë e për të pshurrur nuk të paguan kush. Po makina që s'ha, pse s'ankohet?

Një vajzë e re sot në Bathore është e lirë të dalë në rrugë, është e lirë. Asaj i kanë thënë të dalë dhe të admirohet nga gjahtarët e rrugës, por sytë duhet t'i mbajë në tokë. Shikimi sy më sy është provokim për gjahtarët dhe ç'ndodh më pas është vetëm faji i saj. Ajo do të kthehet në shtëpi para se të erret sepse në terratë nuk e sheh (dhe kontrollon) kush.

Një vajzë e re sot në Bathore është e lirë të punojë sa t'i mbihien duart dhe shpina, është e lirë. Puna kryhet në seri dhe intensitetin e përcakton makina. Nëse dikush

ngelet mbrapa, puna ndalon për të gjithë dhe menaxheri bellpaesan nuk është i lumtur, por ulërin. Ulërin njësoj siç bën të dielave kur kthehet në atdhe dhe shkon në stadium për të bërë tifo për skuadrën e zemrës.

Një vajzë e re sot në Bathore është e lirë të ëndërrojë, është e lirë. Ajo do të donte të shkollohej për mësuesi sepse i adhuron fëmijët, dhe jetën do donte ta kalonte duke u mësuar atyre poema. Por kjo ëndërr u këput herët, e pas dhjetë vjetësh kyçet e duarve të saj do të janë shkatërruar nga fëndyelli që shpon lëkurën, sepse studimi në këtë vend është privilegji i pasani-këve.

Një vajzë e re sot në Bathore është e lirë sepse kështu thotë ligji i botës sonë të emancipuar e demokratike. Por çmimi i lirisë është tepër i lartë për t'u blerë me paratë e punëtores që qep këpucë. ■

Paraja e pisët godet industrinë prodhuese

Pas përgjakjes së rrugëve, cënimit të çdo norme të shëndetshme morale në shoqëri, shkatërrimit të qyteteve nëpërmjet betonizimit të pakriter të tyre dhe gjunjëzimit të rendit ligjor, paraja e drogës po shkatërron edhe industrinë prodhuese në Shqipëri. Zhvleftësimi i monedhës europiane ndaj lekut shqiptar, i cili është forcuar ndjeshëm përballë saj, pavarësisht se ekonomia e vendit vazhdon të mbetet pothuajse primitive kundrejt ekonomive të rajonit e më gjërë, po përkthehet në humbje të mëdha për eksportuesit shqiptarë. Sipas INSTAT, vetëm për shkak të kursit të këmbimit, industria vendase humbi 225 milion euro në vitin 2022.

Masat ndihmuese të shtetit kundrejt situatës, sipas eksportuesve mbulojnë vetëm 10% të humbjeve; dhe nuk ka si të ndodhë ndyshe, duke patur parasysh se qeveria shqiptare, e njohur për amnistimin dhe nxitjen e parasë së pisët, është përgjegjëse për krizën dhe me sa duket, nuk ka ndërmend të ndryshojë kurs



as në të ardhmen e afërt. Por kush do ta paguajë çmimin e aventurës së parasë së pisët?

Ekonomia e vendit, e para. Të dytët, ata 70.000 burra, vajza dhe gra të klasës punëtore të cilët do të mbajët në kurriz pasojat e krizës duke u përzënë nga puna apo duke u mospaguar rregullisht, ashtu siç mbajtën në kurriz krizën e pandemisë, rritjes së kostos së jetesës dhe mbarë industrinë tekstile në këto 20 vjet. Shenjat e kësaj krize po shfaqe gjithandej dhe pothuajse çdo ditë, në një fabrikë diku në Shqipëri, punëtorët po ngrihen në greva të vogla dhe jetëshkurtra, të cilat shtypen ose mashtrohen nga ujdia momentale e inspektorëve të punës me pronarët, po që nuk do të mbahen gjatë nën kontroll dhe premtojnë të bëhen të mëdha në të ardhmen e afërt. Njerëzit e klasës së punës në Shqipëri kanë sakrifikuar shumë dhe nuk duhet ta paguajnë më ata faturën e një krize për të cilën nuk janë fajtorë. ■

Jeta e përditshme në kartonët e rrugës

Artan Hajrullahu (1979, Gjilan, Kosovë) është një emër i ri por mjaft premtues në artet pamore të hapësirës shqiptare. I shkolluar në Universitetin e Arteve në Prishtinë, ai është autor i shumë punimeve në pikturë ku shquhet për një origjinalitet të lartë krijues. Hajrullahu është i

veçantë/autentik jo vetëm në tematikë me pasqyrimin e jetës së përditshme të njerëzve të zakonshëm, me stilin e thjeshtë dhe plot ngjyra, por edhe në praktikën krijuar me kartonët e gjetur në rrugë dhe të kthyer në tablo për krijimet e tij. Më poshtë, disa punime. ■



Fotografitë nga ArtWiever.org

Viti II / Nr VII

E martë, 26 Dhjetor 2023

Organizohu!

tel: 0676431411
e-mail: organizohu@gmail.com

Dimër i vështirë për punëtorët dhe pensionistët

